

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit:	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.:	966
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	7	Data Datum Date:	13.05.2016
Dolëse PRISHTINË/A			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATE/A:	13.05.2016
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar, Zyrtarët për buxhet të organizatave buxhetore
NGA/OD/FROM:	Avdullah Hoti, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2017/01

Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2017-2019, që paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2017.

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2017/01, e cila ofron kufijtë fillestar buxhetor për secilën Organizatë Buxhetore për vitin 2017. Ministria e Financave mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë këtij procesi.

Me respekt,

Avdullah Hoti
Ministër i Financave



Qarkorja Buxhetore 2017/01

1. Qëllimi

Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me Nenin 20 të LMFP, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren e Parë Buxhetore 2017/01, ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019 për çdo Organizatë buxhetore. Pas kësaj qarkoreje do të pasojnë qarkore të tjera shtesë deri në finalizimit të buxhetit për 2017 dhe vlerësimet për 2018-2019.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019

Korniza për buxhetin e vitit 2017 bazohet në KASH 2017-2019, që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe kornizën makrofiskale për vitet 2017-2019. Qeveria është e përkushtuar që, duke ruajtur stabilitetin fiskal, të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara përmes Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë, gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2017/01 është hartuar në pajtim me politikat fiskale, për të cilat Qeveria është dakorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

3. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet - për vitet 2018-2019

Procesi buxhetor për vitet 2017-2019 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore të Qeverisë me nevojat ekonomike dhe sociale të vendit. Përmes kësaj qarkoreje kërkohet që Organizatat buxhetore të reflektojnë në përgatitjen e buxhetit në nivel të programeve dhe nën-programeve, aktiviteteve dhe projekteve individuale.

Organizatave buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioritetëve të Qeverisë,
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake,
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimi (IPA),
- Legjislacionin e ri apo ndryshim plotësimin e atij ekzistues,
- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale,
- Të kujdesen që të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza e tyre buxhetore.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2017 dhe projeksionet 2018-2019.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim të arritjes së prioriteteve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe zhvendosjen e buxhetit nga një organizatë në tjetrën.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë që lidhen me rritjen e qëndrueshme ekonomike, punësimit dhe mirëqenies, sundimi i ligjit, arsimit, shëndetësia dhe integrimet evropiane.

Shpenzimet operative: organizatat buxhetore duhet të ofrojnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcat e bashkangjitura, për vitet 2017-2019. Shpenzimet operative për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019 do të pësojnë ngritje të lehtë në krahasim me vitin 2016. Kjo rritje ka të bëjë kryesisht me kategorinë e Subvencioneve dhe transfereve si rezultat i ndikimit të Vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritje të pensioneve dhe benefiteve të kategorive të tjera sociale.

Punësimi: në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për nevojën e punësimeve të reja, siç është rasti me shndërrimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës. Organizatat buxhetore me rastin e punësimit duhet të mbështeten në ndarjet buxhetore.

Pagat dhe mëditjet: kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje historikisht ka përfaqësuar pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse dhe gjithashtu planifikohet që përgjatë periudhës planifikuese trendi i njëjtë të vazhdojë. Përgjatë periudhës planifikuese, kjo kategori pritet të ngriten gradualisht, e ndikuar kryesisht nga alokimi i mjeteve për implementim të Ligjit për Sigurime Shëndetësore, si dhe implementimi i pjesës së kontratës kolektive që ndërlihet me përvojën e punës. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me FMN-në ka formuluar dispozita të nevojshme ligjore që sigurojnë se ngritja e faturës së pagave në sektorin publik të jetë në harmoni me zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik në vend.

Mallra dhe shërbime: me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si dhe përfshirjes së iniciativave të reja të cilat në vete bartin kosto shtesë për buxhetin, shpenzimet në këtë kategori janë planifikuar të mbajnë pjesëmarrjen e njëjtë në BPV me vitet paraprake, për të shënuar një rënie të vogël vetëm në vitin 2019. Si rrjedhojë, shpenzimet për këtë kategori pritet të shënojnë një ngritje rreth 2% në mesatare përgjatë periudhës planifikuese. Duhet të keni kujdes në planifikimin e buxhetit për këtë kategori dhe t'i shpërndani mjetet e planifikuara në mënyrë objektive nëpër nënkategoritë e mallrave dhe shërbimeve, pasi nga viti i ardhshëm planifikohet që alokimi i mjeteve të bëhet nëpër nënkategoritë të kategorisë mallra dhe shërbime.

Shpenzimet komunale: pritet të ketë një rritje të lehtë vjetore përgjatë periudhës afatmesme krahasuar me vitin 2016, e cila rritje vjen si rezultat e shtimit të shpenzimeve për objekte të reja qeveritare.

Subvencionet dhe transferet: planifikohen të kenë një rritje të moderuar përgjatë periudhës 2017-2019, kjo si rezultat i akomodimit të iniciativave të reja shpenzuese në këtë kategori. Kjo kategori e shpenzimeve reflekton implementimin e Ligjit mbi Veteranet e Luftës, koston e ndryshimit në ligjin e pensioneve si dhe rritjen natyrale të përfituesve në skemat tjera. Për më shumë, kjo kategori e shpenzimeve përmban edhe subvencionet për sektorin e bujqësisë. Në harmoni me planifikimet paraprake dhe me objektivat e Qeverisë për privatizim dhe stabilizimin e funksionimit të ndërmarrjeve publike, subvencionet për ndërmarrjet publike planifikohen të bien në vazhdimësi gjatë periudhës planifikuese.

Shpenzimet Kapitale: kjo kategori e shpenzimeve planifikohet të shënojë një rritje prej rreth 40% në fund të vitit 2019 në raport me shpenzimet e buxhetuara gjatë vitit 2016. Në bazë të kornizës afat-mesme parashihet një ngritje mesatare vjetore prej rreth 12% të shpenzimeve kapitale përgjatë kësaj periudhe. Kjo rritje e konsiderueshme e buxhetit për shpenzimet kapitale është refleksion i programit qeverisës me fokus në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik. Nga kjo pikënisje dhe në harmoni me FMN-në, për të akomoduar nevojat e mëdha të ekonomisë vendore për investime kapitale, është krijuar mundësia që përmes klauzolës së investimeve të këtë ngritje të theksuar në investimet kapitale. Implementimi i projekteve të reja kapitale është i bazuar në një listë prioritare që merr parasysh efektin e këtyre investimeve në ekonomi dhe punësim. Përparësi për financim do të kenë projektet në vazhdim dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritetet e Qeverisë që bazohen në arsyeshmëri të plotë për financim. Të gjitha projektet kapitale mbi një milion euro duhet të përgatiten mbi bazën e analizës **costo benefit**. Rrjedhimisht, kufijtë buxhetor për shpenzime kapitale nëpër organizata buxhetore janë indikativ, dhe Qeveria mban të drejtën t'i ndryshojë ata varësisht nga arsyeshmëria e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore.

4. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it. Është e rëndësishme që prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu si janë paraqitur në “Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2017-2019” në kuadër të KASH-it 2017-2019 të jenë bazë për përgatiten e kërkesave buxhetore dhe identifikim të projekteve kapitale.

Të gjitha Organizatat buxhetore duhet të arsyetojnë plotësisht kërkesat buxhetore për projektet e tyre përmes sistemit të PIP-it.

5. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB – BDMS)

Siç është e njohur, Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit është sistem financiar i cili merret me formulimin e buxhetit dhe planifikimin e shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve. Që tani Sistemi SZHMB është në dispozicion për shfrytëzim nga organizatat buxhetore. Organizatat Buxhetore janë të detyruara që të respektojnë kufijtë e lëshuar me Qarkoren e parë buxhetore. Sistemi i SZHMB dhe sistemi i PIP-it nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren e parë buxhetore.

6. Indikatorët e performancës

Për secilin program dhe për secilin projekt, organizatat buxhetore duhet të prezantojnë indikatorët sasior dhe cilësor të performancës të përmbledhura sipas objektivave që ka çdo Organizatë Buxhetore.

7. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ)

Për herë të parë në procesin e planifikimit të buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet 2018-2019, duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për “përfshirjen e buxhetimit gjinator në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve” (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2017. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Duhet të merrni parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit tuaj komunal për periudhën 2017-2019. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave (MF). Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneks.

8. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019

Organizatat Buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetor të dhënë në tabelën në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për 2017 dhe për dy vitet në vijim. Të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga lëvizjet fiskale apo vendimet e Qeverisë të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese si dhe kualitetit të kërkesave buxhetore. Projektet kapitale të filluara nga vitet e kaluara, të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale mbi mjetet e buxhetuara për organizatat buxhetore përkatës, duhet të përfshihen brenda buxhetit për vitet 2017-2019.

Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijnë:

- Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i agjencionit me të gjitha materialet buxhetore,
- Formularët e PCF-ve të shtypura nga sistemi i BDMS-së, dhe
- Formularët e shtypur nga Sistemi PIP.

Tabela 1: Kufijtë buxhetor për Organizatat Buxhetore qendrore për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019

Kodi org.	Ministritë/Institucionet	Punëtor	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale 2017	Rezerva	2017	2018	2019
101	Kuvendi i Kosovës	353	5,659,017	1,688,759	241,000	60,000	25,000	-	7,673,776	7,692,750	7,711,724
102	Zyra e Presidentit	70	729,678	770,421	18,700	70,000	-	-	1,588,799	1,592,005	1,595,211
104	Zyra e Kryeministrit	674	4,269,980	3,159,627	184,133	1,480,000	2,060,994	-	11,154,734	11,172,515	11,190,295
201	Ministria e Financave	1,802	33,162,018	5,151,366	488,592	4,726,000	8,030,000	-	51,557,976	106,575,441	171,226,721
202	Ministria e Administrimit Publik	270	2,042,922	4,573,852	2,499,600	50,000	4,750,000	-	13,916,374	13,624,109	13,631,843
203	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe	354	2,139,195	2,981,681	118,768	47,383,922	870,000	-	53,493,566	53,482,532	53,491,498
204	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	231	1,406,726	1,744,765	109,280	1,050,000	450,000	-	4,760,771	4,767,282	4,883,792
205	Ministria e Infrastrukturës	296	1,692,187	5,903,323	375,190	1,443,814	187,538,187	-	196,952,701	197,982,225	189,429,936
206	Ministria e Shëndetësisë	1,100	7,472,770	27,960,887	230,548	7,503,725	8,082,000	-	51,249,930	54,564,636	56,628,374
220	Sherbimi Spitalor dhe Klinik Univer	6,720	50,414,864	10,675,909	3,591,416	-	4,028,000	-	68,710,189	69,002,209	69,194,228
207	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Spo	675	3,489,294	725,467	294,323	6,206,550	8,048,684	-	18,764,318	18,900,587	18,916,855
208	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe T	2,065	15,931,068	9,302,672	1,245,259	3,821,929	14,045,000	-	44,345,928	45,162,474	45,279,238
209	Ministria e Punës dhe Mirëqenies S	876	4,943,588	1,872,538	357,085	370,616,006	838,000	-	378,627,217	388,391,880	393,506,427
210	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi	335	2,045,821	1,118,081	83,220	-	37,476,541	-	40,723,663	46,755,783	58,765,114
211	Ministria e Komuniteteve dhe Kithim	117	755,713	375,652	26,154	300,000	6,400,000	-	7,857,519	7,860,825	7,865,131
212	Ministria e Administrimit të Pushtet	151	915,009	254,431	25,500	203,649	3,500,000	-	4,898,589	4,903,011	4,907,432
213	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	173	1,069,443	3,763,669	46,210	4,933,870	10,290,000	-	20,103,192	16,742,845	16,747,498
214	Ministria e Punëve të Brendshme	10,364	74,480,460	18,161,845	1,886,500	2,071,867	12,193,600	-	108,794,272	109,559,125	109,650,379
215	Ministria e Drejtësisë	1,947	12,198,306	4,657,349	922,169	-	1,092,000	-	18,869,824	18,995,667	18,964,510
216	Ministria e Punëve të Jashtme	272	5,560,891	12,403,547	538,051	100,000	756,564	-	19,359,053	19,384,411	19,409,769
217	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kos	3,324	20,740,387	9,963,805	803,015	-	17,180,000	-	48,687,207	48,558,962	48,420,718
218	Ministria për Integrim Evropian	86	607,321	970,962	10,500	50,000	-	-	1,638,783	1,641,705	1,644,577
219	Ministria e Diasporës	66	478,748	992,314	25,500	130,000	-	-	1,626,562	1,628,586	1,630,611
230	Komisioni Rregullativ i Prokurimit P	33	224,731	114,053	8,200	-	-	-	346,984	347,978	348,971
231	Akademia e Shkencave dhe Arteve të	55	703,223	324,943	5,000	-	-	-	1,033,166	1,036,673	1,040,180
235	Autoriteti i Rregullatorit i Komunika	39	378,136	287,232	12,700	-	-	-	678,068	679,998	681,928
236	Ajencioni Kundër-Korrupsion	40	348,556	138,908	8,500	-	-	-	495,964	497,292	498,619
238	Zyra Rregullatorit për Energji	33	427,388	199,332	22,000	-	-	-	648,720	651,008	653,295
240	Organi Shoqëues i Prokurimit	23	166,114	114,355	5,100	-	-	-	285,569	286,517	287,464
241	Ajencia për Ndihmë Juridike Falas	22	135,124	118,192	14,917	-	-	-	268,233	268,884	269,536
242	Univerziteti i Prishtinës	2,081	20,804,494	2,638,845	1,004,793	1,299,000	3,500,000	-	29,247,132	29,101,084	29,415,036
243	Gjykata Kushtetuese e Kosoves	66	970,829	489,965	4,000	-	25,000	-	1,489,794	1,494,460	1,499,127
244	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	23	101,111	59,861	4,845	-	-	-	165,817	166,506	167,194
245	Ajencioni Kosovar i Intelejgencës	90	1,024,643	1,320,282	38,000	450,000	1,000,000	-	3,832,925	3,849,882	3,866,840
246	Këshilli i Kosovës për Trashigimi Ku	16	95,829	85,418	2,550	-	-	-	183,797	184,270	184,743
247	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Para	20	121,937	73,613	7,820	-	-	-	203,370	203,966	204,563
249	Këshilli i Pavarur Mbikqërës për She	26	230,482	52,402	3,825	-	-	-	286,709	287,760	288,812
250	Prokurori i Shtetit	698	5,982,677	1,340,552	199,630	-	100,000	-	7,622,859	7,651,809	7,660,760
302	Zyra e Auditorit Përgjithshëm	146	1,666,705	551,289	34,000	-	45,000	-	2,296,994	2,278,460	2,284,925
313	Zyra Rregullative e Ujit dhe Mbeturi	21	173,810	134,495	6,503	-	-	-	314,808	315,800	316,792
314	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	20	129,403	114,179	11,900	-	-	-	255,482	256,242	257,002
317	Autoriteti i Aviacionit Civil	30	646,122	223,052	13,738	-	-	-	882,912	886,355	889,797
318	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe	77	713,420	386,281	30,600	-	-	-	1,130,301	1,132,811	1,135,322
319	Komisioni i Pavarur i Mediave	31	328,715	347,984	17,000	-	-	-	693,699	695,073	696,448
320	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	88	707,864	6,436,269	48,391	4,200,000	-	-	11,392,524	11,395,838	5,399,151
321	Institucioni i Avokatit të Popullit	78	801,119	390,353	25,500	-	-	-	1,216,972	1,219,783	1,222,593
322	Instituti Gjyqësor i Kosovës	25	178,411	351,000	16,500	-	-	-	545,911	546,785	547,660
328	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2,159	14,108,061	3,613,079	450,000	250,000	600,000	-	19,021,140	19,189,578	19,108,015
329	Ajencia Kosovare i Pronës	242	1,163,790	494,145	92,333	-	43,700	-	1,793,968	1,799,953	1,762,238
251	Ajencioni Shtetëror për Mbrojtjen e	23	216,344	130,448	6,450	-	-	-	353,242	354,203	355,165
253	Ajencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	11	81,407	44,871	9,250	-	2,000,000	-	2,135,528	2,136,203	2,136,878
232	Shpenzimet e Paparashikuara	-	-	-	-	-	4,000,000	2,000,000	6,000,000	6,000,000	6,000,000
	Radio Televizioni i Kosovës	-	-	-	-	9,900,000	-	-	9,900,000	-	-
	Totali	38,537	304,835,851	149,748,320	16,224,758	458,400,332	338,968,270	2,000,000	1,280,077,531	1,343,856,736	1,413,870,935
239	Ajencioni Kosovar i Privatizimit	258	4,375,657	2,230,000	98,000	40,000	80,000	-	6,823,657	6,594,251	6,529,844
	Ajencioni për Shërbim të Navigacionit Ajror	160	2,238,918	522,527	46,500	-	-	-	2,807,945	4,818,150	4,828,355
	Totali i përgjithshëm me AKP dhe ASHNA	38,955	311,450,426	152,500,847	16,369,258	458,440,332	339,048,270	2,000,000	1,289,709,133	1,355,269,137	1,425,229,134

9. Kufijtë buxhetor për Komuna për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019

9.1. Baza ligjore dhe parimet e financimit komunal

Parimet, kriteret dhe formulat të zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale të përgatitur nga Ministria e Financave, siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Kufijtë e financimit për komunat për periudhën 2017-2019 janë aprovuar nga Komisioni i Granteve me datë 21 prill 2016 si pjesë integrale e KASH 2017-2019 aprovuar në Qeveri me datë 29 prill 2016.

Komunat janë të obliguara të përgatisin Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2017-2019, si dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Kuvendi Komunal shqyrton dhe aprovon Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB), e publikon në faqen zyrtare të komunës dhe një kopje dorëzohet në Departamentin e Buxhetit në MF deri me datë 30.06.2016.

Të gjitha Komunat të cilat parashikojnë që gjatë vitit 2017 të financojnë projekte përmes emetimit të instrumenteve financiare/huamarrjes shtetërore komunale ose garancive komunale, duhet paraprakisht të ju nënshtrohen dispozitave ligjore përkatëse të përcaktuara me LMFPP gjegjësisht Pjesa IX, Ligjit për Borxhin Publik Nr. 03/L -175 Pjesa II - Huamarrja Komunale, si dhe Rregullores QRK nr. 22/2013 Mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore, Garancive shtetërore dhe Borxheve komunale, gjegjësisht Nenit 9 dhe 10.

9.2. Grantet komunale

a) Granti i Përgjithshëm për vitin 2017 dhe parashikimet 2018-2019

Bazuar në Tabelën 1, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Fiskale të Ministrisë së Financave në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2017 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 149,200,000 euro. Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL, ku 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore iu ndahen komunave, duke përjashtuar të hyrat vetanake të nivelit qendror, mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga dividenda, grantet e përcaktuara të donatorëve si dhe taksat dhe ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Tabela 2: Përcaktimi i shumës së Grantit të Përgjithshëm për komuna për 2017-19 (mil. Euro)

	2017	2018	2019
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	1,644.0	1,701.0	1,779.0
Zbriten:			
Të hyrat vetanake të niveli Qendror	(45.0)	(46.0)	(47.0)
Mbështetja buxhetore dhe grante	(1.0)	-	-
Tatimi në pronë	(25.0)	(25.0)	(26.0)
Të hyrat nga dividenda	(15.0)	(15.0)	(15.0)
Grantet e përcaktuara të donatorëve	(12.0)	(12.0)	(12.0)
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	(54.0)	(54.0)	(54.0)
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm	1,492.0	1,549.0	1,625.0
C. Granti i përgjithshëm (10% e B)	149.2	154.9	162.5

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%).

Tabela 2: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe parashikimet 2018-2019 (mil. Euro)

Faktorët	2016	2017	2018	2019
	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi
Granti i përgjithshëm	134.9	149.2	154.9	162.5
Granti i Përgjithshëm i shpërndarë në komuna		145.2		
Kontigjenca për korrektime të formulës		4.0		
Shuma Fikse	3.6	3.6	3.6	3.6
Popullsia (banorë)	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021
Buxheti: 89% e shumës agregate	116.8	125.99	134.62	141.38
Zona komunale (km ²)	10,901	10,901	10,901	10,901
Buxheti: 6% e shumës agregate	7.9	8.5	9.1	9.5
Komunitetet pakicë në komunë	107,926	107,926	107,926	107,926
Buxheti: 3% e shumës agregate	3.9	4.3	4.5	4.8
Popullsia e komunave pakicë	62,031	62,031	62,031	62,031
Buxheti: 2% e shumës agregate	2.6	2.8	3.0	3.2

Është paraparë kontigjenca për korrektime të formulës për shpërndarje të pjesës së grantit të përgjithshëm për komuna në vlerë prej 4 milionë euro, i cili korrektime do të mbështetet në plotësim-ndryshimin e Ligjit të financave të pushtetit lokal ose në vendim të qeverisë.

Tabela në vijim përcakton ndarjen e grantit të përgjithshëm nëpër komuna sipas formulës të përcaktuar në tabelën më lartë.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar, për Shëndetësi primare dhe Shëndetësi sekondare (Graçanicë, Shtërpcë dhe Mitrovicë Veriore) si dhe Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS, financohen nga Granti i Përgjithshëm në komuna.

b) Granti specifik për Arsim parauniversitar për vitin 2017

Granti Specifik për Arsim sipas LFPL bazohet në qasjen me sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret dhe parametrat në formulën shtetërore të arsimit parauniversitar të propozuar nga MASHT për vitin 2017. Formula shtetërore e arsimit parauniversitar trajton në veçanti nivelin e shkollave parafillore, fillore dhe të mesme, duke marrë parasysh këto elemente:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2015/2016;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3;
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin para fillor dhe fillor (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT);
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm (gjimnazet dhe shkollat profesionale bazuar sipas Udhëzimit administrativ nr.18/2009 të MASHT);
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje) bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT;
- k) Shërbimi profesional 80 pedagogë;
- l) Pagat janë kalkuluar duke u bazuar në pagën mesatare sipas niveleve për të gjitha komunat;
- m) Përvoja e punës është kalkuluar duke marrë mesataren prej 15 vite;
- n) Kalkulimi për stafin mësimdhënës në lehonë është paraparë 3% (bazë stafi mësimdhënës).

Granti specifik për arsim parauniversitar për vitin 2017 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 163.4 milion euro. Po ashtu, është rritur numri i stafit për 7 punëtorë për Qendrën Korrektuese në komunën e Lipjanit. Duke qenë se në vitin e ardhshëm shkollor, sipas MASHT, pritet të ketë mbi 10,000 nxënës më pak në arsim parauniversitar, atëherë kjo nënkupton se financimi për kokë nxënësi është rritur krahasuar me vitin 2016.

c) Granti specifik për Shëndetësi primare për vitin 2017

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2017 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 44,085,037 euro, ku krahasuar me vitin 2016 ka një rritje prej 2 milion euro.

Nga Ministria e Shëndetësisë janë transferuar 5 punëtorë dhe pagat total prej 27,645 euro në dy komuna si vijon: (komuna e Junikut, 3 punëtorë dhe pagat 16,587 euro) dhe (komuna e Parteshit, 2 punëtorë dhe pagat 11,058 euro). Nga kjo rezulton se granti i shëndetësisë rritet edhe për shumën e pagave të transferuara nga MSH prej 27,645 euro, që në total reflekton 44,112,682 euro.

Shpërndarja e grantit specifik për Shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL. Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2017 është përgatitur në harmoni me prioritet e qeverisë, projeksionet në KASH dhe propozimit nga MSH, si dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Granteve të dala nga raporti vjetor mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal për vitin 2015 të aprovuar në Qeveri me datë 30 mars 2016, ku si kriter bazë është marrë numri i popullsisë sipas komunave.

Tabela 5: Granti specifik për Shëndetësi për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019

Nr.	Komuna	Popullsia	Total 2017 (bazuar në numrin e popullsisë)	Total 2018 (bazuar në numrin e popullsisë)	Total 2019 (bazuar në numrin e popullsisë)
1	Deçan	40,019	991,134	991,134	991,134
2	Dragash	33,997	841,990	841,990	841,990
3	Ferizaj	108,610	2,689,899	2,689,899	2,689,899
4	Fushë Kosovë	34,827	862,546	862,546	862,546
5	Gjakovë	94,556	2,341,829	2,341,829	2,341,829
6	Gjilan	90,178	2,233,401	2,233,401	2,233,401
7	Glogoc	58,531	1,449,613	1,449,613	1,449,613
8	Ilani i Flezit	9,403	232,880	232,880	232,880
9	Istog	39,289	973,054	973,054	973,054
10	Junik	6,084	167,267	167,267	167,267
11	Kaçanik	33,409	827,427	827,427	827,427
12	Kamenicë	36,085	893,702	893,702	893,702
13	Klinë	38,496	953,414	953,414	953,414
14	Leposavic	13,773	341,110	341,110	341,110
15	Lipjan	57,605	1,426,679	1,426,679	1,426,679
16	Malishevë	54,613	1,352,577	1,352,577	1,352,577
17	Mamushë	5,507	136,390	136,390	136,390
18	Mitrovicë	71,909	1,780,940	1,780,940	1,780,940
19	Novobërdë	6,729	166,654	166,654	166,654
20	Obiliq	21,549	533,695	533,695	533,695
21	Pejë	96,450	2,388,737	2,388,737	2,388,737
22	Podujevë	88,499	2,191,818	2,191,818	2,191,818
23	Prishtinë	198,897	4,925,999	4,925,999	4,925,999
24	Prizren	177,781	4,403,028	4,403,028	4,403,028
25	Rahovec	56,208	1,392,080	1,392,080	1,392,080
26	Shtërpcë	6,949	172,103	172,103	172,103
27	Shtime	27,324	676,722	676,722	676,722
28	Skenderaj	50,858	1,259,579	1,259,579	1,259,579
29	Subarekë	59,722	1,479,110	1,479,110	1,479,110
30	Viti	46,987	1,163,707	1,163,707	1,163,707
31	Vushtrri	69,870	1,730,441	1,730,441	1,730,441
32	Zubin Potok	6,616	163,856	163,856	163,856
33	Zveçan	7,481	185,279	185,279	185,279
34	Graçanicë	10,675	264,383	264,383	264,383
35	Klllokot	2,556	63,303	63,303	63,303
36	Mitrovica Veriore	12,326	305,273	305,273	305,273
37	Partesh	1,787	55,316	55,316	55,316
38	Ranillug	3,866	95,748	95,748	95,748
	Total	1,780,021	44,112,682	44,112,682	44,112,682

d) Financimi për Shëndetësinë sekondare për vitin 2017

Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2017 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 2,603,077 euro sipas prioriteteve të qeverisë, projeksionet në KASH dhe propozimit nga MSH, për tri komunat minoritare, si vijon:

- Komuna e Shtërpçës, financimi prej 522,371 euro
- Komuna e Mitrovicës së veriut, financimi prej 989,935 euro dhe
- Komuna e Graçanicës, financimi prej 1,090,771 euro.

Gjithashtu, është aprovuar nga Komisioni i Granteve rritja e numrit të punëtorëve për 20 punëtorë në shëndetësinë sekondare në Komunën e Graçanicës.

e) Financimi për Shërbimet rezidenciale

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për komunat e cekura si në tabelë sipas MPMS për vitin 2017 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 1,620,000 euro.

Tabela 6: Financimi për shërbime rezidenciale për vitin 2017

Komunat	Total
Skenderaj	180,000
Graçanicë	300,000
Deçan	160,000
Ferizaj	160,000
Istog	180,000
Kamenicë	160,000
Lipjan	160,000
Shtime	160,000
Vushtrri	160,000
Total	1,620,000

- f) Për zbatimin e legjislacionit në fuqi me planifikimin e buxhetit për vitin 2017, ndahen mjetet financiare për Komunën e Prizrenit në shumë prej 40,350 euro lidhur me mbulimin e shpenzimeve operacionale për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Qendrën Kulturore Historike të Fshatit Zym, si dhe për Komunën e Rahovecit në shumë prej 22,743 euro lidhur me mbulimin e shpenzimeve operacionale për Këshillin e Hoçës së Madhe.

9.3. Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2017 dhe parashikimet 2018-2019

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2017 bazuar në Tabelën 1 Makro në shumë prej 79 milion euro, inkorporohen si pjesë e KASH Komunal 2017-2019, si burim i financimit komunal bazuar në LFP. Shpërndarja e këtij projeksioni të të hyrave vetanake nëpër komuna është bazuar në rekomandimet e grupit punues i themeluar për këtë qëllim. Grupi punues ka propozuar shpërndarjen e projeksionit në bazë të parametrevë: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, si dhe të hyrat tjera komunale. Secilit parametër i është dhënë pesha specifike. Në bazë të këtyre parametrevë, shpërndarja e projeksionit është përshtatur për disa komuna me realizimin e të hyrave në vitin 2015.

Tabela 7: Projektionet e të Hyrave vetanake komunale për vitin 2017-2019

Nr.	Komunat	Të Hyrat Vetanake 2017	Plani i Të Hyrave Vetanake 2018	Plani i Të Hyrave Vetanake 2019
1	Deçan	1,309,444	1,309,444	1,326,019
2	Dragash	751,675	751,675	761,190
3	Ferizaj	4,472,188	4,472,188	4,528,798
4	Fushë Kosovë	3,035,973	3,035,973	3,074,403
5	Gjakovë	3,616,260	3,616,260	3,662,035
6	Gjilan	4,599,390	4,599,390	4,657,610
7	Glogoc	1,474,005	1,474,005	1,492,663
8	Hani i Elezit	239,854	239,854	242,890
9	Istog	1,226,695	1,226,695	1,242,223
10	Junik	141,987	141,987	143,784
11	Kaçanik	861,014	861,014	871,913
12	Kamenicë	899,181	899,181	910,563
13	Klinë	1,030,521	1,030,521	1,043,566
14	Leposaviq	198,013	198,013	200,519
15	Lipjan	2,108,547	2,108,547	2,135,237
16	Malishevë	1,097,142	1,097,142	1,111,030
17	Mamusha	105,826	105,826	107,166
18	Mitrovicë	2,436,932	2,436,932	2,467,779
19	Novobërdë	218,829	218,829	221,599
20	Obiliq	1,044,713	1,044,713	1,057,937
21	Pejë	4,429,046	4,429,046	4,485,110
22	Podujevë	1,847,800	1,847,800	1,871,190
23	Prishtinë	24,607,375	24,607,375	24,918,861
24	Prizren	6,102,106	6,102,106	6,179,348
25	Rahovec	1,247,732	1,247,732	1,263,526
26	Shtërpcë	446,914	446,914	452,571
27	Shtime	573,460	573,460	580,719
28	Skenderaj	1,187,875	1,187,875	1,202,911
29	Suharekë	1,934,756	1,934,756	1,959,247
30	Viti	1,106,695	1,106,695	1,120,704
31	Vushtrri	2,316,735	2,316,735	2,346,061
32	Zubin Potok	90,486	90,486	91,631
33	Zveçan	102,771	102,771	104,072
34	Gracanicë	1,700,483	1,700,483	1,722,008
35	Kllkot	104,297	104,297	105,617
36	Mitrovica veriore	177,463	177,463	179,709
37	Partesh	42,483	42,483	43,021
38	Ranillug	113,334	113,334	114,769
	Total	79,000,000	79,000,000	80,000,000

9.4. Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019

Komisioni i Granteve në takimin e datës 21 prill 2016 ka aprovuar grantet qeveritare për financimin e komunave përfshirë projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2017, ku total burimet e financimit komunal janë aprovuar në shumën prej 439.96 milion euro (tabela 8).

Tabela 8: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-19 për komunat

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019
1. Grantet qeveritare	338.32	361.03	366.73	374.33
Granti i përgjithshëm	134.91	149.20	154.90	162.50
Granti i përgjithshëm		145.20		
Kontigjenca për korrektim të formulës		4.00		
Granti specifik për shëndetësi	42.08	44.11	44.11	44.11
Granti specifik për arsim	161.33	163.43	163.43	163.43
2. Grantet për kompetencat e shtuara	2.60	2.66	2.66	2.66
Kujdesi shëndetësor dytësor	2.60	2.60	2.60	2.60
Qendra Historike në Prizren dhe Qendra Kulturore Historike në Fshatin Zym dhe për Këshillin e fshatit Hoçe e Madhe		0.06	0.06	0.06
3. Transferi i Shërbimeve rezidenciale	0.24	1.62	1.62	1.62
Shërbimet rezidenciale: Deçan, Ferizaj, Istog, Kamenicë, Lipjan, Shtime, Vushtri, Graçanicë dhe Skenderaj	0.24	1.62	1.62	1.62
4. Të hyrat vetanake komunale	80.00	79.00	79.00	80.00
TOTAL FINANCIMI KOMUNAL	421.16	440.03	445.73	454.33

9.5. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për komuna 2017-2019

Struktura e kategorive ekonomike operative për komunat për vitin 2017 është në nivelin e njëjtë krahasuar me vitin 2016 me një rritje prej 2.1 milion euro tek kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, ndërsa kategoria ekonomike për shpenzime kapitale ka një rritje prej 15.8 milion euro si rezultat i rritjes së grantit të përgjithshëm për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016.

Tabela 9: Struktura e shpenzimeve për buxhetin komunal për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet 2018-2019

Kategoritë Ekonomike	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Stafi	43,832	43,864	43,864	43,864
Paga dhe medijtje	248,432,392	248,279,572	249,356,773	250,433,673
Mallra dhe shërbime	38,222,300	40,334,225	40,334,225	40,334,225
Shpenzime komunale	9,797,595	9,797,595	9,797,595	9,797,595
Subvencione dhe transfere	8,667,743	8,667,743	8,667,743	8,667,743
Rezerva				
Shpenzimet kapitale	117,090,589	132,951,730	137,574,529	145,097,329
Total	422,210,618	440,030,865	445,730,865	454,330,565

10. Kalendarri kohor për procesin buxhetor për vitin 2017

Hapi i parë në përgatitjen e buxhetit për 2017-2019 është bërë me aprovimin e KASH-it 2017-2019 nga Qeveria dhe dërgimi në Kuvendin e Kosovës, që është kryer më 29.04.2016. Hapi tjetër është lëshimi i Qarkores Buxhetore 2017/01, që është ky dokument. Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjatë procesit buxhetor për 2017-2019 për Organizata Buxhetore të nivelit qendror dhe për komunat.

10.1. Kalendarri kohor për nivelin qendror

Organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet t'i përmbahen këtij kalendarri kohor në përgatitjen e buxhetit të tyre:

- 20 Qershor: Organizatat buxhetore dorëzojnë në MF kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, sipas programeve dhe kategorive ekonomike. Kërkesat buxhetore duhet të jenë plotësisht të arsyetuara përmes përdorimit të sistemit të BDMS-se dhe PIP-it.
- 24 Qershor: Departamenti i makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale.
- 30 Qershor: Qarkore buxhetore 2017/02 do të lëshohet sipas nevojës dhe do të adresoj vetëm çështjet specifike të reja të cilat kanë rezultuar pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
- 14 Korrik: Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore atëherë këto informata duhet të dorëzohen nga Organizatat buxhetore në Ministrinë e Financave, Departamentin e Buxhetit deri në këtë datë.
- 29 Gusht - 2 Shtator: Dëgjimet buxhetore (pas pranimit të materialeve nga organizatat buxhetore). Pjesëmarrës në dëgjime do të jenë zyrtarët të organizatave buxhetore, stafi i MF, Zyra e Kryeministrit, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Orari i dëgjimeve buxhetore do të bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2017/02. Nëse është e mundur në këto dëgjime, do të shikohet mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës suaj për vitin 2017.
- 8 Shtator: Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Fiskale në MF paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, posaçërisht indikatorët që lidhen me procesin buxhetor 2017-2019.
- 12 Shtator - 16 Shtator: konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetore.

- 19 Shtator: nxjerrja e Qarkores së tretë buxhetore me kufijtë final buxhetor.
- 26 Shtator - 28 Shtator: Ankesat nga Organizatat Buxhetore.
- 29 Shtator - 30 Shtator: Takimet e Qeverise për ti shqyrtuar ankesat e organizatave buxhetore.
- 13 Tetor: Drafti i parë i buxhetit në MF dhe dërgimi i këtij drafti në Qeveri.
- 14 Tetor - 26 Tetor: miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri.
- 28 tetor: Dorëzimi i Draft Buxhetit 2017 në Kuvendin e Republikës së Kosovës siç specifikohet në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

10.2. Kalendari kohor për nivelin komunal

Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e buxhetit të tyre:

- 30 Qershor: aprovimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit për komunë,
- 30 Shtator: Aprovimi i buxhetit komunal për 2017-2019 në Kuvendin Komunal,
- 30 Shtator: pas aprovimit të propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentet si në vijim:
 - Shkresa përcjellëse bazuar ne aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
 - Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2017-2019, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
 - Tabelate buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
 - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2017-2019 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF).
 - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2017 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2018-2019 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF).
 - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF).

Departamenti i Buxhetit në MF do të organizojë forume me autoritetet komunale lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitin 2017-2019. Gjithashtu, përmes trajnimeve shtesë do të ofrohen udhëzime me specifike rreth hartimit të buxhetit për secilën nga fazat kyçe, përfshirë aplikimin e sistemeve elektronike SZHMB dhe PIP. Të gjitha kërkesat për Buxhet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Ministrinë e Financave..

Aneks: Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2014					
2015					
2016					
Planifikimi për 2017					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2017 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

